



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:251375  
Datë: 29.04.2024  
Numri i dokumentit: 05637006

KPPP.nr.1910/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit AGANI L.t.d. Sh.P.K., me seli në magjistralen Prishtinë-Ferizaj Km i 5-të, Komuna e Graçanicës, me NUI: 811282706, kundër debitorit Olive Medical Group Sh.P.K., me adresë në Prishtinë, rruga Ymer Aliu, blloku 1, kompleksi banesor-afarist Riera, objekti afarist “Qendër Afariste”, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit P.nr.292/23 të datës 02.11.2023, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Eset Murati me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 29.04.2024, mori këtë:

**AKTVENDIM**

- I. REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit Olive Medical Group Sh.P.K., ashtu që Urdhri P.nr.292/23 i datës 02.11.2023, i lëshuar nga Përmbaruesi Privat Eset Murati MBETET NË FUQI në tërësi.

**A r s y e t i m**

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin P.nr.292/23 të datës 02.11.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumenteve të besueshme – faturave dhe atë: Faturës Nr.1-3399 të datës 11.10.2022, Faturës Nr.1-3405 të datës 11.10.2022, Faturës Nr.1-3458 të datës 14.10.2022, Faturës Nr.1-3475 të datës 14.10.2022, Faturës Nr.1-3598 të datës 24.10.2022, Faturës Nr.1-3757 të datës 03.11.2022, Faturës Nr.1-3781 të datës

07.11.2022, Faturës Nr.1-3810 të datës 07.11.2022, Faturës Nr.1-4066 të datës 24.11.2022, Faturës Nr.1-4067 të datës 24.11.2022, Faturës Nr.1-4081 të datës 25.11.2022, Faturës Nr.1-4188 të datës 05.12.2022, në vlerë prej 515.27 Euro (nga kjo shumë/faturë janë paguar 215.89 Euro), Faturës Nr.1-1922 të datës 15.05.2023, Faturës Nr.1-2134 të datës 30.05.2023, Faturës Nr.1-2151 të datës 30.05.2023, Faturës Nr.1-2179 të datës 01.06.2023, Faturës Nr.1-2191 të datës 02.06.2023, Faturës Nr.1-2254 të datës 07.06.2023, Faturës Nr.1-2399 të datës 19.06.2023, Faturës Nr.1-2467 të datës 22.06.2023, Faturës Nr.1-2491 të datës 23.06.2023, Faturës Nr.1-1644 të datës 26.04.2023, Faturës Nr.1-3115 të datës 21.09.2022, në vlerë prej 464.94 Euro (nga kjo shumë/faturë janë paguar 436.02 Euro), Faturës Nr.1-2224 të datës 05.05.2023, dhe Faturës Nr.1-2223 të datës 05.06.2023, duke urdhëruar debitorin që të paguajë në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura, shumën në lartësi prej 5,311.65 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrimit të Përbaruesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me të cilin konsideron se dokumentacioni i ofruar nga ana e propozuesit për përbarim, duhet të rishikohet nga debitori, sepse ne si kompani jemi të detyruar që të analizojmë mirë dhe në detaje për validitetin e këtyre faturave, në kuptim të pranimit të mallit nga ana e personave përgjegjës si dhe shumave që reflektohen në fatura. Më tej ka theksuar se si debitor do të paguajë të gjitha borxhet e mbetura ndaj kreditorit, të cilat janë të faktuara në kartelat financiare të debitorit dhe kreditorit, dhe jo shuma paushalle të përcaktuara në fatura, e të cilat nuk janë pranuar nga personat përgjegjës dhe nuk kanë faksimilën e institucionit, përderisa të njejtat nuk verifikohen dhe të konstatohet drejtë gjendja faktike. I ka propozuar gjykatës që prapësimi të pranohet si i bazuar dhe të anulohet në tërësi urdhri i Përbaruesit Privat.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se prapësimi i debitorit është tërësisht në funksion të prolongimit të pagimit të borxhit që debitori ka ndaj kreditorit, ngase asnjëri nga kundërshtimet e debitorit nuk përbëjnë shkaqet e prapësimit të cilat në mënyrë taksative parashihen në nenin 71 të LPP-së. Më tej ka shtuar se debitori nuk ka ofruar asnjë provë për të mbështetur pretendimet e tij, dhe se të gjitha faturat e dorëzuara nga kreditori përmbajnë nënshkrimin e pranuesit të mallit dhe faturës, si dhe përmbajnë vulën e institucionit Olive, dhe kjo pa mëdyshje nënkupton se personi përgjegjës e ka pranuar mallin dhe nënshkruar/vulosur secilën faturë. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përbarimor i Përbaruesit Privat.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarim dokumentet e besueshme: Faturën Nr.1-3399 të datës 11.10.2022, Faturën Nr.1-3405 të datës 11.10.2022, Faturën Nr.1-3458 të datës 14.10.2022, Faturën Nr.1-3475 të datës 14.10.2022, Faturën Nr.1-3598 të datës 24.10.2022, Faturën Nr.1-3757 të datës 03.11.2022, Faturën Nr.1-3781 të datës 07.11.2022, Faturën Nr.1-3810 të datës 07.11.2022, Faturën Nr.1-4066 të datës 24.11.2022, Faturën Nr.1-4067 të datës 24.11.2022, Faturën Nr.1-4081 të datës 25.11.2022, Faturën Nr.1-4188 të datës 05.12.2022, në vlerë prej 515.27 Euro (nga kjo shumë/faturë janë paguar 215.89 Euro), Faturën Nr.1-1922 të datës 15.05.2023, Faturën Nr.1-2134 të datës 30.05.2023, Faturën Nr.1-2151 të datës 30.05.2023, Faturën Nr.1-2179 të datës 01.06.2023, Faturën Nr.1-2191 të datës 02.06.2023, Faturën Nr.1-2254 të datës 07.06.2023, Faturën Nr.1-2399 të datës 19.06.2023, Faturën Nr.1-2467 të datës 22.06.2023, Faturën Nr.1-2491 të datës 23.06.2023, Faturën Nr.1-1644 të datës 26.04.2023, Faturën Nr.1-3115 të datës 21.09.2022, në vlerë prej 464.94 Euro (nga kjo shumë/faturë janë paguar 436.02 Euro), Faturën Nr.1-2224 të datës 05.05.2023, dhe Faturën Nr.1-2223 të datës 05.06.2023, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit monetar, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt i cili vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e debitorit në këto fatura.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1910/23, me datë 29.04.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.